



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:263965

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520042

PKR.nr.32/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trurpit Gjykes-Gjyqtari Fatos Sejdiqaj me zyrtarin ligjor Bardh Sylejmani-procesmbajtës, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarës H.U.nga ..., për shkak dy veprave penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), dhe veprës penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së Nr.06/L-074, rikualifikuar nga Prokurori i shtetit në veprën penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së Nr.04/L-082, e akuzuar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore ne Mitrovice-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.302/2022, të datës 04.02.2022, PP.I.nr.395/2022 të datës 23.12.2022 dhe PP.II.nr.232/2019 të datës 30.01.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 21.03.2024 i cili ka qenë i hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Njazi Rexha, e akuzuara H.U.dhe Mbrojtësja e saj, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Shqipe Mehmeti-Jusufi, më datën 22.03.2024 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 28.03.2024, e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

- E akuzuara :

H.U., nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ..., e lindur me datë ... në ..., me adresë vendbanimi në ..., Rr.”...” Nr., me numër personal ..., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, e martuar – nënë e dy (2) fëmijëve, pensioniste e Republikës së Kosovës, e gjendjes së dobët ekonomike.

- ËSHTË FAJTOR -

I.-SEPSE : Me datë 22.11.2018 në cilësinë e personit zyrtar – zyrtare e gjendjes civile në Komunën e Vushtrrisë, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare ka tejkalar kompetencat e saj me qëllim që tjetrit t’i sjelli dobi, në atë mënyrë që në kundërshtim me udhëzimin administrativ Nr.11/17 neni 3 par. 1 e 2, ka bërë rishkrimin nga libri fizik në regjistrin qendror elektronik, të D.D. pa ndonjë dokument që vërteton identitetin e tij dhe pajisë në certifikatën e lindjes.

II.- SEPSE : Në cilësinë e personit zyrtar - zyrtare e gjendjes civile në Komunën e Vushtrrisë, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare ka tejkalar kompetencat e saj me qëllim që tjetrit t’i sjelli dobi, në atë mënyrë që me datë ... kishte regjistruar në librin amzë të të lindurve personin M.M., ndërsa me datë ... në kundërshtim me Ligjin 04/L-003 për gjendjen civile dhe procedurat e regjistrimit të personave sipas udhëzimit administrativ Nr.11/2017 neni 3 par.1 e 2 e regjistron në regjistrin qendror elektronik të gjendjes civile dhe pajiset me certifikatë të lindjes.

III.- SEPSE : Më datë 02.04.2019 në pozitën e zyrtares të Zyrës së Gjendjes Civile pranë KK-Vushtrri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të një dobie për vete ose tjetrit, ka shpërdorur pozitën e saj zyrtare duke i tejkalar kompetencat në atë mënyrë që bënë rishkrimin e personit R.D. nga libri fizik i lindjes në regjistrin qendror elektronik ku e përfshin në sistemin elektronik më datë ... pa dëshmi të prezantuara nga aplikanti pa dokumente që vërtetojnë identitetin e palës kërkuese, e që në këtë mënyrë e akuzuara i mundëson personit R.D. që të aplikoi për nxjerrjen e dokumenteve të Republikës së Kosovës ku i njëjti pajiset me ekstrakt të lindjes me numër ...

- Me këtë ka kryer veprën penale në vazhdim-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 73, 81 dhe nenit 422, par.1 të KPRK-së, dhe neneve 358, 361, 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452 par.1 të KPP-së, të akuzuarën e :

- G J Y K O N -

I.- Me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Obligohet e akuzuara që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të

krimit shumë prej pesëdhjetë (50.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.- Kërkesë pasurore – juridike nuk kishte.

- A r s y e t i m -

- Rrjedha e çështjes –

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzat PP.II.nr.231/2019 të datës 04.02.2022, PP.II.nr.232/2019 të datës 30.01.2023 dhe PP.II.nr.395/2022 të datës 23.12.2022, kundër të pandehurës H.U.nga ..., për shkak të veprave penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së Nr.04/L-082 dhe për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së Nr.06/L-074, rikualifikuar nga Prokuori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar në veprën penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së Nr.04/L-082.

- Meqenëse ndaj të akuzuarës H.U., në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ishin duke u zhvilluar tri (3) lëndë penale PKR.nr.32/2022-(2021:263965), PKR.nr.302/2022-(2022:222361) dhe PKR.nr.23/2023-(2021:184298), e duke qenë se e akuzuara akuzohej për vepër penale të njëjtë, Gjykata në mbështetje të dispozitës ligjore nga neni 34 par.7 dhe 8 të KPP-së, sipas detyrës zyrtare me datë 09.02.2024 ka nxjerrë Aktvendim procedural PKR.nr.32/2022, me të cilin ka bashkuar procedurat penale në këto lëndë penale dhe procedura penale ndaj të akuzuarës ka vendosur që të zhvillohet me numrin e lëndës PKR.nr.32/2022 si lëndë e pranuar dhe regjistruar me herët nga Gjykata, dhe Gjykata për tri (3) aktakuzat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.231/2019 të datës 04.02.2022; PP.I.nr.232/2019 të datës 30.01.2023 dhe PP.I.nr.395/2022 të datës 23.12.2022 do të vendos me një aktgjykim.

- Gjykata në këtë çështje penale më datë 21.03.2024 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ishin prezent Prokurori i shtetit Njazi Rexha, e akuzuara H.U.dhe Mbrojtësja e saj, sipas detyrës zyrtare Av.Shqipe Mehmeti-Jusufi.

- Gjykata konform nenit 241 par.1 të KPP-së, të akuzuarën e ka njoftuar me të drejtat e saj procedurale dhe e njëjta ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e saj, sa i përket mbrojtjes në këtë çështje penale ka deklaruar se dëshiron të mbrohet përmes mbrojtësës së saj caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Shqipe Mehmeti-Jusufi.

- Duke qenë se në këtë çështje penale e akuzuara tani akuzohej për vepër penale në vazhdim-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, meqë mbrojtja është e detyruar, me aktvendim procedural Gjykata duke vepruar në përputhje me nenin 56 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike të akuzuarës i është caktuar Av. Shiqpe Mehmeti-Jusufi nga Mitrovica.

- Vlerësimi i pranimi të fajësisë –

- Pas leximit të aktakuzave nga ana e Prokurorit të shtetit, ndër të tjera lidhur me aktakuzën PP.II.nr.395/2022 të datës 23.12.2022, për veprën penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së Nr.06/L-074, bëri rikualifikimin ligjor të saj duke theksuar se nga kjo vepër penale, neni 414 par.2 të KPRK-së, duhet të jetë vepra penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, si vepër e kryer në kohën që ka qenë në fuqi Kodi – KPRK Nr.04/L-082.

- Më pas Gjykata të akuzurën e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe beneficionet e pranimi të fajësisë, ashtu që e njëjta pas këshillimeve të mjaftueshme më Mbrojtësen e saj, ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzave, pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare dhe pa imponime njëherësh, shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, duke shprehur pendimin e saj të thellë lidhur me veprimet e saj, ndësa shtoi se afërsisht që katër vite është në pension dhe kërkoi nga Gjykata që ndaj saj të shqiptojë një dënim sa më të lehtë.

- Pas pranimi të fajësisë nga e akuzuara, Gjykata e kërkojë mendimin nga Prokurori i shtetit, i cili me këtë rast deklaroi se, akuzuara pranimin e fajësisë për këto tri vepra penale e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion në konsultim me Mbrojtësen e saj e në mbështetje të provave që gjenden në shresat e lëndës andaj, i propozojë Gjykatës që ta aprovojë pranimin e fajësisë.

- Poshtua, Gjykata e kërkoi mendimin dhe nga Mbrojtësja e të akuzuarës e cila përveç tjerash deklaroi se, e mbështetë pranimin e fajësisë nga e akuzuara, i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare dhe të vetëdijshme nga ana e saj, ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimit tim si mbrojtëse ashtu që, i propozoi Gjykatës që të aprovojë të njëjtën. Sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit ka propozuar që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese

dher atë pranimin e fajësisë, pendimin e thellë të saj, moshën e shtyer shatëtdhjetë (70) vjeçare duke kërkuar që të aplikojë dhe dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në KPRK.

- Pas pranimit të fajësisë nga e akuzuara dhe pas marrjes së mendimit nga Prokurori i shtetit dhe Mbrojtësja e saj, Kryetari i trupit gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 242 par.6 lidhur me par.2 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka miratuar pranimin e fajësisë nga e akuzuara lidhur me veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzave ngase, konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga e akuzuara dhe se e njëjta i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Gjykata ia kishte tërhequr vërejtjen të akuzuarës se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e njëjta është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

- Gjendja faktike e vërtetuar –

- Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga e akuzuara, në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, Gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të akuzuarës kemi të bëjmë me elementet e veprës penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, me të cilën akuzohet sipas aktakuzave. Kjo konstatohet nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si : Përgjigjen e M.S. – Drejtor i Drejtorisë për Administratë Nr. ... dt. ..., Kopja – detaje nga historia aktuale e qytetarit nga sistemi elektronik i Agjencionit të Regjistrimit Civil, Kopja e librit amzë së të lindurve me nr. vijues ..., Kopja e faqes së librit të gjendjes civile Novolan – Vushtrri (...) që përfundon me nr., Kopja e faqes së librit të gjendjes civile Novolan - Vushtrri të cilës i është bashkangjitur faqja me nr. ., i regjistruar D.D. me datë ..., dhe Kopja e faqes së librit të gjendjes civile (Novolan – Vushtrri) sipas së cilës viti 1979 përfundon me nr. rendor ., Kërkesën e Agjencisë së Regjistrimit civil me nr. të referencës ... për inicimin e rastit, Kopjen e kërkesës nga Konsullata e Republikës së Kosovës në Londër, me referencë ..., Kopjen e faqes së parë

të librit amëz të të lindurve (rikonstruim), Kopjen e librit amëz të të lindurve, faqen .. nr. vijues ..., Kopja e librit amëz të të lindurve, faqe .. nr. vijues ..., të datës ..., Kopja e librit amëz të të lindurve faqe nr., nr. vijues ..., kopja e certifikatës së lindjes të datës ... – Prizren, Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës lëshuar me datë ..., Kopjen e pasaportës së Republikës së Kosovës, lëshuar me datë ..., Kopja e formularit të aplikimit për letërnjoftim datë ... Fushë Kosovë, Kopja e formularit të aplikimit për pasaportë, datë ... Fushë Kosovë, Kopja nga sistemi i gjendjes civile / historia e qytetarit, Referenca nga inspektorati i ARC-së dt.... së bashku me një kopje të formularit në emër të R.D. (kopje e marrur nga libri RL.... Vushtrri), Referenca ... e dt...., Përgjigja me shkrim nga Zyra e gjendjes civile Nr.... datë ..., Formulari lidhur me historinë e shërbimeve të qytetarit në emër të R.D. lidhur me lëshimin e ekstraktit të lindjes me numër serik ... datë ..., Vendimi Nr.... i dt...., Dokumenti mbi të dhënat e qytetarit-rishkrimi i lindjes-gjenerimi i numrit personal datë ..., deklaratat e të pandehurës, si dhe shkresat tjera të lëndës.

- Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga e akuzuara dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se e akuzuara, është e përgjegjshme dhe përgjegjës (fajtores) për veprat penale për të cilat akuzohet, për çka Gjykata i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që veprat penale dhe aktakuzat e bashkuara, t'i cilësojë si veprë penale në vazhdim pasi që, në bazë dispozitivit të tyre, gjegjësisht përshkrimit faktik të veprave penale në raport me shkresat e lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 81 par.1, nënpar.1.2, 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së.

Neni 81 par.1 i KPRK-së përcakton se : *“Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lishdhmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të së paku dy prej kushteve në vijim”* :nëpar.1.2 :”objekti i njëjtë i veprës penale”, ...nëpar.1.4 : “vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale dhe ...nëpar..1.5 : “dashja e njëjtë e kryesit”.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin Gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarën si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se e njëjta gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet, me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë tjetër lehtësuese Gjykata mori rrethanat e saj personale se e njëjta është nënë e dy (2) fëmijëve, moshën e saj të shtyer shtatëdhjetë (70) vjeçare,

pensioniste e Republikës së Kosovës, pastaj pendimin e saj të thellë si dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me veprimet e saj ndërsa, **si rrethanë rënduese** në rastin konkret Gjykata gjeti shkallën e dashjes dhe përgjegjësisë penale të saj, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë.

- Përveç rrethanave të sipërtheksuara, bazuar në verifikimet që janë bërë përmes Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK) në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, nga Zyra për Menagjimin e Lëndëve njoftuar me parashtresën me shkrim P.nr.32/2022 të datës 22.03.2024, si rrethanë tjetër rënduese Gjykata mori **dënimet e mëparshme penale ndaj saj** ashtu që, ka vërtetuar se ndaj të akuzuarës, përveç kësaj lënde janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton e dënuar me Aktgjykime të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të rënda, P.nr.11/2020, i plotëfuqishëm nga data 25.09.2020, për veprën penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së,
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të rënda, P.nr.275/2020, i plotëfuqishëm nga data 12.06.2023, për veprën penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të rënda, P.nr.136/2022, i plotëfuqishëm nga data 12.06.2023, për veprën penale-Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së.

- Sipas vlerësimit të Gjykatës, Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj ndaj të akuzuarës duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

- Andaj, Gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarës i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Gjykata ndaj të akuzuarës nuk ka shqiptuar dënim plotësues përcaktuar si në nenin 65 të KPRK-së, Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, pasi që e akuzuara tani më është pensionuar.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, Gjykata e mori duke u bazuar në nenet 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj Gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

-Departamenti për Krime të Rënda-

PKR.nr.32/2022, datë 28.03.2024.

Zyrtari ligjor

Bardh Sylejmani

Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari

Fatos Sejdiqaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.